



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr.1442/6 Prot.

Tiranë, më 30/07/2019

**V E N D I M**

**Nr.32, Datë 30/07/2019**

**PËR  
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË  
AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
“MBIKËQYRJA E SHFRYTËZIMIT TË BURIMEVE HIDROENERGJETIKE”  
“MBI PËRPUTHSHMËRINË”  
për periudhën nga data 01.09.2016 deri më datën 31.12.2018**

Nga auditimi tematik “Mbi Përputhshmërinë” i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore me objekt “Mbikëqyrja e Shfrytëzimit të Burimeve Hidroenergjetike”, për periudhën 01.09.2016 deri më 31.12.2018, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale por jo të përhapura, për të cilën japim *opinion të kualifikuar*.

AKBN, pavarësisht përpjekjeve nuk ka arritur të përmbush pritshmërinë për monitorim të plotë dhe efektiv të kontratave për ndërtimin dhe shfrytëzimin e veprave hidroenergjetike, të cilat kanë impakt të rëndësishëm si në aspektin mjedisor ashtu edhe në ekonominë e vendit. Evidentohet se, veprimtaria monitoruese është shoqëruar nga mungesa të theksuara të kompetencave ligjore dhe/ose të deleguara për miradministrimin e procesit, burime njerëzore të pamjaftueshme por dhe mangësi organizative ku veçojmë, mungesën e koordinimit dhe bashkëveprimit me ministrinë e linjës edhe hallka të tjera institucionale që veprojnë në këtë drejtim, ndryshime të shpeshta dhe të pastuduara në strukturën organizative, mosinformatizim i proceseve të punës, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik “Për, Përputhshmërinë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, “Mbikëqyrja e Shfrytëzimit të Burimeve Hidroenergjetike”, sipas programit të auditimit nr. 1442/2 prot. datë 29.01.2019, për veprimtarinë nga data 01.09.2016 deri më datën 31.12.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## OPINIONI I AUDITIMIT

### Për drejtimin e AKBN-së

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon mbikëqyrjen e shfrytëzimit të burimeve hidroenergjetike, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

### Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë<sup>1</sup>, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***<sup>2</sup>

### Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000<sup>3</sup>)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

### Nga evidencat e marra për veprimtarinë e AKBN-së në fushën hidroenergjetike rezultoi se:

Kryerja e oponencës teknike për veprat hidroenergjetike paraqet mangësi, sa i përket përbërjes së grupit të Oponencës Teknike (OT), shpërblimit të tyre, llogaritjes dhe pagesës së tarifave përkatëse si dhe zbatimit të afateve të përcaktuara në kryerjen e saj.

Evidentohen, afate të zgjatura për hartimin dhe dërgimin e raporteve tre mujore drejt Ministrisë së linjës, mosvënie në punë e sistemit informatikë *Re.....*, mungesë bashkëveprimi me institucionet fiskale, ndryshime të shpeshta dhe jo të mirë menduara të strukturës së AKBN, mungesë e

<sup>1</sup> Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

<sup>2</sup> **ISSAI 4000** – Udhërrëfytyri i Auditimit të Përputhshmërisë

<sup>3</sup> Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

specialiteteve të nevojshme në grupin e OT, stafin e drejtorisë monitoruese të HEC-eve si dhe plotësim i vonuar i akteve të brendshëm rregullatorë të cilat kanë ndikuar negativisht në veprimtarinë së AKBN-së për fushën hidroenergjetike.

***Bashkëveprimi dhe koordinimi me MIE paraqet mangësi, ku përmendim:***

Mungesa e lejeve për kryerjen e punimeve të ndërtimit në veprat hidroenergjetike, njoftimeve për testimin e veprave, apo dokumentacioneve të tjera në dosje, të trajtuara në raportet e monitorimit, nuk evidentohet të pasohen me veprime konkrete nga ana e MIE në rolin e autoritetit kontraktor për adresimin institucional të tyre.

Moslidhja e kontratave shtesë nga MIE, për projektet e zbatimit vlerësuar pozitivisht nga OT-ja dhe të miratuar prej saj, të cilat kanë rritje të prodhimit vjetor të energjisë krahasuar me kontratën bazë, ka bërë që, mbajtja e *Fee-së* vjetore në favor të shtetit të jetë më e ulët se ajo që duhej në fakt.

Ndërkohë që AKBN në vijimësi rekomandon penalitete për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga ana e shoqërive zhvilluese, nga MIE nuk disponohen informacione lidhur me zbatimin e tyre, duke krijuar një situatë kaotike.

Megjithëse problematikat e evidentuara përcillen në MIE, nëpërmjet informacioneve të veçanta apo atyre periodike, ato mbarten vazhdimisht pa marrë zgjidhje përfundimtare prej saj.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij në fushën hidroenergjetike, ku do të veçonim që, vlera e parregullsisve kap një vlerë të konsiderueshme rreth **15,178 milion lekë**.

***Përgjegjësia e Drejtimit***

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Detyrat specifike lidhur me veprimtarinë përcaktohen në Statut Rregullorë, Rregulloren e Brendshme dhe dokumentin “Përshkrimet e punës së punonjësve të AKBN”.

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, raportimi periodik çdo tre muaj i procesit të ndërtimit dhe/ose prodhimit të HEC-eve nuk respektohet thuajse në të gjitha rastet prej shoqërive zhvilluese të veprave hidroenergjetike, megjithëse ky është një detyrim kontraktual referuar nenit 18 të kontratës koncesionare dhe nenit 16 në kontratat tip për HEC-et nën 2MW. Sipas të dhënave të AKBN-së për vitin 2018, vetëm 13% e shoqërive zhvilluese ndodhen brenda përcaktimeve të kontratës koncesionare për deklarinimin, ndërsa 87% e tyre, janë ose mosdeklarues ose kanë mangësi të theksuara në raportimet periodike. Për 122 kontrata koncesionare efektive gjatë kësaj periudhe janë kryer vetëm 180 raportime nga 488 të detyrueshme. Niveli i ulët i raportimeve periodike nga tregon për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale ana e shoqërive zhvilluese si dhe ka ndikuar negativisht në veprimtarinë monitoruese të drejtorisë përkatëse në AKBN, sa i përket planifikimit, monitorimit në terren të punimeve, ndjekjen në kohë të problematikave të evidentuara si dhe propozimet efikase për Autoritetin Kontraktor. Vlen të theksojmë se, mungesa e dispozitave ligjore për aplikimin e sanksioneve direkt nga AKBN për këto raste “*ka kontribuar*” në krijimin e një situatë të disfavorshme për procesin e monitorimit. Nga ana e MIE, pavarësisht raporteve të AKBN-së, nuk evidentohet të jenë marrë masa për rregullimin e gjendjes, drejt përmirësimit të kontratave

apo nxjerrjes së akteve rregullatorë për procesin, element që kërkon një vëmendje të shtuar në vijim. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** Për të rritur efikasitetin e procesit të monitorimit në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, për rastet e mosraportimit periodik nga ana e shoqërive zhvilluese, MIE të marrë nismat e nevojshme për përmirësimin e bazës ligjore apo dispozitave të kontratës me sanksione penalizuese si dhe të rishikoj kompetencat e AKBN<sup>së</sup> si institucionin zbatues të tyre.

*Menjëherë*

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 14 dosjeve të cilët kanë përfunduar punimet, janë lidhur me rrjetin energjetik dhe janë futur në fazën e prodhimit u konstatua se:

- Sigurimi i kontratës/kontratave nga Koncesionari/Koncesionarët është bërë vetëm për një vit, ndërkohë që zbatimi/përfundimi i punimeve ka zgjatur disa vite, në kundërshtim me nenin 14 “Sigurimi i kontratës” të Kontratës TIP lidhur midis tyre dhe Autoritetit Kontraktor.

- Koncesionari në asnjë rast nuk ka bërë sigurim të pajisjeve etj, dhe s’ka përcjellë pranë AK kopjet certifikuar të çdo certifikatë sigurimi, në kundërshtim me nenin 15 “Sigurimet” të kontratës TIP.

- Drejtoria e Monitorimit të Kontratave Koncesionare të HEC-ve përgjithësisht, nuk ka bërë monitorimin në terren për çdo tre muaj, në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në “Rregulloren e Brendshme” të AKBN.

- Në dosje nuk gjenden raportimet që duhet të bëjë Koncesionari çdo tre muaj me shkrim pranë AK, për realizimin e programit të investimeve etj, në kundërshtim me nenin 18 “Raportimi” të kontratës Për HEC-e të veçantë si G... etj, është kryer vetëm një monitorim, kur HEC-i ka qenë në fazën e prodhimit.

- Në asnjë rast nuk u konstatua të jetë propozuar, ose mbajtur qëndrim (sanksione) ndaj shoqërive të cilat nuk përmbushin detyrimin kontraktual “Raportimi” mbi raportimin periodik të ecurisë së kontratës referuar nenit 12, pika 1.6. “Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit”.

- Në dosjet e koncesionare, përgjithësisht nuk gjendet “Testimi” i kryer nga vet Koncesionari, rezultatet e tij, në kundërshtim me nenin 11 “Testimi i veprës” të kontratës TIP. Mos realizimi sipas detyrimit kontraktual, i këtij procesi, sjell si pasojë kalimin në fazën e prodhimit të shoqërive koncesionare të cilat kanë detyrime të pashlyera ndaj shtetit (penalitetet, taksa për marrjen e Lejeve apo ndryshimin e tyre etj), shmang kontrollin e cilësisë së realizimit të veprës në raport me detyrimet kontraktuale, etj.

- Në asnjë rast nuk është bërë përfundimi i veprës brenda afatit të përfundimit të punimeve (përgjithësisht një vit) të parashikuar në kontratën lidhur midis palëve, por ai ka zgjatur me vite (deri nëntë vite), në kundërshtim me nenin 10 “Programi i punimeve” të kontratës së lidhur.

- AKBN, e gjithë struktura përgjegjëse e saj, nuk ka njoftuar Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në mungesë të lejes së ndërtimit, megjithëse me këtë të fundit është lidhur marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim informacioni.

Në përgjithësi HEC-et janë vendosur në punë në kushtet që Koncesionarit i ka përfunduar leja e ndërtimit kohë më parë dhe nuk e ka rinovuar, ose, nuk është i pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi në kundërshtim me nenin 15, 16 të VKM nr. 502, datë 13.7.2009 i ndryshuar dhe nenin 10.1. “Programi i punimeve” të parashikuara në kontratë. Kryerja e punimeve e pa shoqëruar me leje zhvillimi/ndërtimi është në kundërshtim me nenin 8 etj, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, gjithashtu, bie ndesh me nenin 8.3, 8.16 etj. të kontratës koncesionare të lidhur.

- Në asnjë rast preventivët e veprave, nuk janë ndërtuar mbështetur në manualet e çmimeve në ndërtim, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” pika 1 dhe 2.

- Në dosjen e veprës, përgjithësisht nuk gjendet situacioni përfundimtar i punimeve të kryera, për rrjedhojë mungon dhe mundësia për të krahasuar vlerën e shpenzimeve të kryera, me ato të parashikuara në preventive, për të bërë të mundshëm njoftimin/korrigjimin eventual të taksave e të detyrimeve të tjera të cilat vendosen në përqindje ndaj tyre si taksa e ndikimit në infrastrukturë etj. nga organet përkatëse.

- Në gjashtë Raporte të monitorimit të shqyrtuara për HEC-et, mungon propozimi me vlerën përkatëse sipas detyrimit kontraktual të penalitetit që rrjedh nga neni 23 “Sanksionet” i kontratës së koncesionit lidhur midis palëve që lidhet me vonesat në fillimin / përfundimin e punimeve.

Gjithashtu mungon llogaritja e penalitetit për mosrealizimin e prodhimit sipas detyrimit kontraktual për periudhën para daljes së VKM-së Nr. 332 datë 06.06.2018.

- Përgjithësisht dosjet e HEC-ve, nuk janë inventarizuar e arkivuar dhe dokumentacioni që përmbajnë është kryesisht fotokopje, çka ul shkallën e besueshmërisë së përfundimeve dalë nga të dhënat e dosjeve. Sa më sipër në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Vlera e penaliteteve të propozuara nga ana e AKBN drejt MIE, për moszbatim të kushteve të kontratës, për të cilat nuk disponohen aktet administrativë për arkëtimin e tyre, vetëm për rastet e shqyrtuara shkon në rreth 2,025,281 mijë lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të bëjë vlerësimin e duhur të situatës lidhur me parregullsitë e konstatuara, si dhe të marrë masa për sjelljen e procesit brenda “kornizës ligjore”. Mbi bazën e gjithë rekomandimeve të shprehura nga AKBN në vijimësi për secilën kontratë nëpërmjet raporteve tremujore të monitorimit apo shkresave të veçanta, të saktësojë penalitetet për moszbatim të kushteve të kontratës dhe të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerave përkatëse, një kopje e të cilave të dërgohet pranë AKBN<sup>së</sup>.

*Brenda datës 30.11.2019*

**1.2 Rekomandimi:** AKBN, për rastet e përmendur më lartë si edhe në të gjitha rastet e mungesës së llogaritjes së penalitetit në raportet e monitorimit apo shkresave të veçanta të llogaris penalitetet e munguara dhe ti dërgoj ato nëpërmjet një raporti të veçantë në MIE.

*Brenda datës 31.10.2019*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, procesi i monitorimi të prodhimit vjetor të energjisë elektrike paraqet mangësi të theksuara ku përmendim:

Institucionet shtetërore që kryejnë shit-blerjen e energjisë nga shoqëritë zhvilluese, sipas kontratave të lidhura mes tyre, nuk dërgojnë në AKBN informacione periodike lidhur me prodhimin vjetor dhe *tarifën koncesionare/Fee-në* të mbajtur prej tyre. Me shkresa të përsëritura është kërkuar informacion për prodhimin, apo lidhjet e reja të HEC-eve me rrjetin energjetik por përgjigjet e kthyer janë jo të plota ose pjesore, ndërkohë që informacioni duhet të ishte periodik dhe i strukturuar. Në disa prej informacioneve vihet re se, shoqëritë kanë filluar prodhimin e energjisë elektrike pa praninë e AKBN-së në procesin e testimit të veprës, si dhe pa u kryer më parë certifikimi i investimit të kryer, në kundërshtim me dispozitat e kontratës së lidhur.

Mangësi paraqiten në llogaritjen dhe mbajtjen e *Fee-së* vjetore, kjo sa i përket vlerësimin të shkaqeve ligjore kur nuk arrihet kuota e parashikuar e prodhimit vjetor si dhe në llogaritjen e penalitetit për këtë mosrealizim. Në vijimësi, nuk disponohet informacion nga MIE, lidhur me vlerat e penaliteteve të zbatuara në këtë drejtim.

Po kështu, dispozitat e reja ligjore, VKM nr. 332 datë 06.06.2018 dhe Udhëzimi nr.10496 datë 31.07.2018, dalë në zbatim të tij, kanë përcaktuar elementë si frekuenca e monitorimeve dhe mesatarizimi i energjisë për efekt penaliteti, të cilat i kanë kanë thelluar më tej paqartësitë në

drejtim të monitorimit të prodhimit. AKBN, i është drejtuar zyrtarisht MIE për interpretimin tekniko-ligjor të këtyre dispozitave, por nga kjo e fundit nuk ka ende një përgjigje konkrete. Mungesa e informacioneve të plota dhe periodike, si dhe interpretimeve ligjore, kanë ndikuar negativisht në përmbushjen veprimtarisë monitoruese. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 92-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për hartimin e një databaze ndërvepruese me AKBN dhe plotësimin e saj me të gjitha sanksionet e vendosura sipas raporteve të monitorimit në nivel kontrate dhe HEC-i prej fillimit të veprave si dhe vlerat e arkëtuara prej tyre.

*Brenda datës 30.11.2019*

**2.2 Rekomandimi:** MIE, në rolin e autoritetit kontraktor dhe organit epror ti garantojë AKBN<sup>së</sup> suportin e nevojshëm tekniko ligjor për trajtimin e kontratave, informacione periodike vjetore, të strukturuar lidhur me prodhimin për çdo HEC, si dhe Fee-të përkatëse të mbajtur nga autoritetet. Të kryhen veprimet e nevojshme administrative dhe ligjore për kufizimin e lidhjes së energjisë nga ana e operatorëve shtetërorë pa u kryer më parë testimi i veprës dhe certifikimi i investimit.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, midis kontratave koncesionare të lidhura dhe projekteve të zbatimit të veprave të cilët janë vlerësuar pozitivisht nga grupi i OT-së dhe miratuar prej Autoritetit Kontraktor, evidentohen ndryshime thelbësore sa i përket prodhimit vjetor të energjisë. Këto ndryshime, pavarësisht rekomandimit të lënë në çdo raport të OT-së për amendim kontrate, nuk janë përmbyllur në të gjitha rastet me kontrata koncesioni shtesë, mungesa e të cilave ka bërë që, *Fee-ja* koncesionare të llogaritet mbi kontratën bazë dhe jo mbi parametrat e rinj të miratuar në projekt zbatim. Moslidhja në kohë e kontratave shtesë nga ana e Ministrisë së linjës, në rolin e Autoritetit Kontraktor, krijon efekte financiare negative në buxhet. Sipas të dhënave të AKBN për vitet 2017 dhe 2018, për të paktën 23 kontrata në prodhim të plotë të cilat kanë rritje të energjisë vjetore në projekt zbatim krahasuar me kontratën bazë, efektet financiare për *Fee* të pa llogaritur kapin vlerën rreth 22,820 mijë lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 92-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1 Rekomandimi:** MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për lidhjen e kontratave shtesë të përmendura më lartë, por jo vetëm, sipas parametrave të projektzbatimit të paraqitur prej Oponencës Teknike dhe vlerësuar pozitivisht prej saj.

*Brenda datës 30.11.2019*

**3.2 Rekomandimi:** Për të gjitha kontratat me HEC-et në fazë prodhimi të cilat kanë rritje të prodhimit vjetor të energjisë në projektzbatim, të pa finalizuara ende me kontratë shtesë, AKBN të llogaris vlerën e *Fee-së* të pa mbajtur dhe të përcjellë aktet përkatës drejt MIE për kontabilizimin dhe vjeljen e detyrimit.

*Brenda datës 30.10.2019*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e pagesave të kryera për periudhën nën auditim konstatohet se, AKBN ka kryer shpërblimin e anëtarëve të brendshëm të grupit OT-së në periudha mujore sipas urdhrin të Ministrit nr.39, datë 18.02.2015, veprim i cili bie ndesh me përcaktimet Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, e ndryshuar, “Për funksionimin e grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”

konkretisht nenit 3, pika 5 ku përcaktohet se; “Numri i specialistëve të jashtëm dhe shpërblimi i tyre përcaktohen me vendim të këshillit drejtues të AKBN”. Kjo dispozitë përcakton vetëm kompetencat e Këshillit Drejtues lidhur me numrin e specialistëve të jashtëm, por në të nuk trajtohet pagesa dhe shpërblimi i punonjësve të brendshëm. Megjithëse kjo problematikë është trajtuar edhe gjatë auditimit të mëparshëm AKBN vijon të kryej pagesat për anëtarët e OT, punonjës të brendshëm të institucionit. Vlera e pagesave të kryera në mungesë të akteve ligjore mbështetës, llogaritet në 4,060,000 lekë. Pavarësisht përcaktimit të pikës 5 më sipër, organet kolegjiale drejtuese të njësive publike nuk kanë kompetencë ligjore për përcaktimin e masës së shpërblimit kompetencë e cila sipas ligjit nr.10405, neni 4 pika 3 i përket Këshillit të Ministrave. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1 Rekomandimi:** Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, për plotësimin e bazë ligjore lidhur me pagesat e anëtarëve të brendshëm të Grupit të OT-së, i cili “*de jure*” dhe “*de facto*” ushtron veprimtarinë si një organ kolegjial.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave të oponencës teknike, për vlerësimin e projekteve të zbatimit për veprat hidroenergjitike, sa i përket aspektit procedural të veprimtarisë së OT-së si dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore në fuqi u konstatua se: Në përmbajtjen e Raporteve të OT-së nuk evidentohen vlerat e makinerive dhe paisjeve, vlerat e investimit në disa raste janë të paraqitura me TVSH, në disa të tjera nuk përcaktohet nëse ky tatim përfshihet në vlerën e preventivuar. Ka pasaktësi në paraqitje, sa i përket vlerës gjithsej të investimit krahasuar me shumën e vlerave sipas secilit HEC. Për disa nga HEC-et nën 2 MW, mungon raporti i vlerësimit nga MEI. Evidentohen vonesa në dërgimin e projekteve të zbatimit të cilat nuk justifikohet me dokumentacion.

Në të gjitha rastet, projekt zbatimi është vlerësuar pa u paguar më parë tarifa përkatëse, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 8 të Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, e ndryshuar, “Për funksionimin e grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”. Në tre raste tarifa e oponencës është llogaritur në mënyrë të pasaktë me efekt financiar të munguar që llogaritet 5,567,357 lekë (me tvsh). *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**5.1 Rekomandimi:** AKBN, të marrë masat për përfshirjen në raportet e vlerësimit të OT-së të vlerës së investimit dhe makineri dhe pajisjeve në të dy mënyrat, (me Tvsh/pa Tvsh) si dhe të sanksionohet pagesa e tarifës përpara hyrjes në oponencë.

*Në vijimësi*

**5.2 Rekomandimi:** Për tre rastet e konstatuara më sipër me llogaritje të pasaktë të tarifës në shumën 5,567,357 lekë, të kryhet rivlerësimi i tarifës në përputhje me procedurat ligjore.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi bazën e të dhënave shpresore dhe elektronike të paraqitura nga subjekti i audituar, lidhur me respektimin e afateve në kryerjen e oponencës teknike për projektet e zbatimit, përbërjes dhe vendimmarrjes së grupit të Oponencës Teknike u konstatua se:

**A.** Në 69 nga 128 projektet e zbatimit të vlerësuar pozitivisht, për HEC-e nën 2MW, afati i vlerësimit nga OT shkon **nga 100 deri 463 ditë** kalendarike, duke tejkaluar afatet e përcaktuara për nxjerrjen e vlerësimit përfundimtar.

-Në 17 nga 24 projektet e zbatimit për HEC-e nën 2MW të përcjella nga Ministria e linjës ende nuk janë vlerësuar nga OT megjithëse kanë **nga 127 deri 422 ditë** kalendarike në AKBN duke tejkalluar afatet e përcaktuara në rregullore.

-Në 10 nga 34 projektet e zbatimit të vlerësuar pozitivisht, për HEC-et me koncesion, afati i vlerësimit nga OT shkon **nga 110 deri 337 ditë** kalendarike pas kryerjes së pagesës në kundërshtim me, përcaktimet e nenit 7 pika 6, e Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, "Për funksionimin e grupit për kryerjen e oponentëve teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN".

**B.** Sipas të dhënave për periudhën nën auditim AKBN ka përfshirë në vendimmarrje dhe specialistët e jashtëm me të drejtë vote pa u mbështetur në dispozita ligjore të mirpërcaktuara. Sipas VKM nr. 547 datë 09.08.2006, "Për krijimin e agjencisë kombëtare të burimeve natyrore", i ndryshuar pika 3 e saj, "Detyrat dhe përgjegjësitë e AKBN", përcakton se për raste të veçanta AKBN mund të kërkojë asistencë të specializuar: Në nenin 3, pika 3,4,5 e Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, përcaktohet se; "Për specialitete të cilat nuk janë në strukturën e AKBN, apo për të cilat kërkohet një ekspertizë më profesionale, pranë grupit të OT, të punojnë dhe ekspertë jashtë strukturave të AKBN". Pra vendimi nr. 547 "Për Krijimin e AKBN" dhe rregullorja specifike e OT-së flasin qartë për mbështetje teknike prej ekspertëve të jashtëm por në asnjë moment nuk trajtojnë rolin vendimmarrje të tyre në OT.

Për periudhën nën auditim Shtator 2016-Dhjetor 2018 numri i ekspertëve të jashtëm të kontraktuar pjesmarrës në këtë organ kolegjal ka qenë më i lartë se numri i anëtarëve punonjës të AKBN duke bërë që ky organ kolegjal efektivisht të kryej një "oponencë të pavarur" dhe jo oponencën shtetërore, megjithëse AKBN zotëron dhe ka patur mundësi për rekrutim të gjithë kapaciteve të nevojshme njerëzore për pjesmarrje të plotë konform rregullores në këtë grup. Institucioni nuk dispononte aktet e nevojshme ligjore apo rregullativë për kriteret që duhet të plotësojnë ekspertët e jashtëm për kontraktim, si dhe ato mbi të cilat të bazohet përzgjedhja e punonjësve të brendshëm në OT, duke e lënë procesin tërësisht në subjektivizëm, duke eliminuar barazinë në përzgjedhje dhe mbi të gjitha në mungesë të plotë transparence.

**C.** Nga verifikimi i profileve të diplomimit të anëtarëve të OT-së u konstatua se, në përbërjen e grupit rezulton vetëm një anëtar specialist hidroteknik prej vitit 2016, ndërkohë që dispozita rregullative përcakton minimalisht dy të tillë, çka bie ndesh me, nenin 6 pika 2 dhe nenin 7 pika 12, të rregullores së përmendur më lartë.

Funksionimi i këtij organi vendimmarrës vetëm me 1 (një) anëtar specialist hidroteknik nga 2 (dy) të tillë minimalisht të nevojshëm për këtë profil paraqet problematika të rënda lidhur me ligjshmërinë e vendimarrjeve të kryera nga ky organ. Nëse shohim profilet e specialiteteve të disponueshme në AKBN vërehet se, vetëm në Drejtorinë Hidroenergjitike në AKBN zotërojnë këtë profil të paktën 4 punonjës, pra hapësirat për plotësimin e këtij profili kanë qenë lehtësisht të mundshme por që nuk janë shfrytëzuar prej drejtimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**6.1 Rekomandimi:** MIE, të rishikojë rolin vendimmarrës të ekspertëve të jashtëm në grupin e Oponentëve Teknikë sipas rregullores, të plotësohen aktet e nevojshme rregullativë për kontraktimin e tyre konform kriterëve të duhura arsimore dhe profesionale nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues.

**Brenda datës 30.09.2019**

**6.2 Rekomandimi:** AKBN, të plotësojë profilet e munguara në stafin e Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve si dhe të përcaktojë kriteret më të larta profesionale dhe eksperience për rekrutimet e reja.

***Në vijimësi***



**6.3 Rekomandimi:** AKBN, të marrë masat e nevojshme për eliminimin e vonësive në paraqitjen e projekteve dhe vlerësimin e tyre në OT duke respektuar radhën e shqyrtimit sipas modelit FIFO.

*Në vijimësi*

## **C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, midis kontratave koncesionare të lidhura dhe projekteve të zbatimit të veprave të cilët janë vlerësuar pozitivisht nga grupi i OT-së dhe miratuar prej Autoritetit Kontraktor, evidentohen ndryshime thelbësore sa i përket prodhimit vjetor të energjisë. Këto ndryshime, pavarësisht rekomandimit të lënë në çdo raport të OT-së për amendim kontrate, nuk janë përmbyllur në të gjitha rastet me kontrata koncesioni shtesë, mungesa e të cilave ka bërë që, *Fee-ja* koncesionare të llogaritet mbi kontratën bazë dhe jo mbi parametrat e rinj të miratuar në projekt zbatim. Mos lidhja në kohë e kontratave shtesë nga ana e Ministrisë së linjës, në rolin e Autoritetit Kontraktor, krijon efekte financiare negative në buxhet. Sipas të dhënave të AKBN për vitet 2017 dhe 2018, për të paktën 23 kontrata në prodhim të plotë të cilat kanë rritje të energjisë vjetore në projekt zbatim krahasuar me kontratën bazë, efektet financiare për *Fee* të pa llogaritur kapin vlerën rreth **22,820 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 92-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrativë dhe ligjorë për rikuperimin e vlerës së munguar në buxhet për 23 kontratat e trajtuara në vlerën rreth **22,820 mijë lekë**.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi mënyrën e faturimit të tarifës për kryerjen e shërbimit të oponencës teknike u konstatua se, me ndryshimet ligjore të ndodhura me Vendimin nr. 206 datë 15.03.2017 i Këshillit të Ministrave, për një shtesë në vendimin nr. 547 datë 09.08.2006, “Për krijimin e agjencisë kombëtare të burimeve natyrore”, mënyra e llogaritjes së tarifës ndryshoi nga ajo mbi bazë vlere/grupi tarifor dhe përqindjes, me atë mbi bazë fuqie të projektit të veprës sipas klasifikimeve. Prej datës 21 Mars 2017 nga e cila kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja deri më 31 Dhjetor 2018 konstatohet se, në 169 fatura të prera shërbim oponence teknike, AKBN nuk ka llogaritur TVSH-në mbi vlerën e tarifës por në mënyrë të pasaktë e ka përfshirë tatimin brenda saj. Kjo mënyrë faturimi ka ndikuar në uljen e vlerës së faturimit të këtij shërbimi në masën 20 për qind, duke ulur për rrjedhojë të ardhurat e institucionit. Theksojmë se shërbimet e ndërtimit në vijimësi janë klasifikuar si shërbim i tatueshëm me TVSH gjë e cila vijon. Mënyra e faturimit të këtij shërbimi gjendet qartësisht në aktet ligjore dhe konkretisht, në nenin 16 të Vendimit nr. 354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” Ligjit nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar Neni 2/a , Neni 39 etj. Vlera e munguar në buxhetin e njësisë publike nga faturimi i pasaktë i shërbimit të oponencës teknike kap shumën prej **7,020,000 lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** Nga AKBN, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin diferencës së tarifës prej **7,020,000 lekë** si dhe të merren masat e nevojshme për mos përsëritjen e problematikës në vijim.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave të oponencës teknike, për vlerësimin e projekteve të zbatimit për veprat hidroenergjitike, sa i përket aspektit procedural të veprimtarisë së OT<sup>së</sup> si dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore në fuqi u konstatua se:

Në të gjitha rastet projekt zbatimi është vlerësuar pa u paguar më parë tarifa e shërbimit të oponencës teknike, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 8, të Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, “Për funksionimin e grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”. Në katër raste të evidentuara tarifa përkatëse e oponencës teknike mungon, e për rrjedhojë në arkën e shtetit nuk kanë hyrë të ardhurat në shumën **1,617,463 lekë (me tvsh)**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1 Rekomandimi:** Nga AKBN, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin vlerës së tarifave të munguara në shumën prej **1,617,463 lekë**, e cila mungon në buxhetin e njësisë publike.

*Menjëherë*

### **C.1.1 MASA SHPËRBLIM DËMI DERI NË VERIFIKIMIN E PLOTË TË SITUATËS**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e AKBN-së lidhur me dokumentacionet e disponuara në dosjet e shoqërive të kontraktuara për ndërtimin dhe shfrytëzimin e veprave hidroenergjetike u konstatua se, në 28 raste shoqërive zhvilluese u *mungon/ka munguar* leja nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të ndërtimit. Veç aspekteve të tjera ligjore, mungesa e lejes ndikon në kufizimin e të drejtës për kreditimin e TVSH-së, për ato punime që janë kryer pa leje apo në shkelje të saj. Nga të dhënat financiare të këtyre shoqërive, publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) lidhur me investimet e deklaruar nga ana e tyre në Pasqyrat Financiare vjetore, Tvsh-ja e kredituar për vlerat e punimeve të situacionuara dhe kontabilizuara në mungesë të lejes përkatëse për 11 nga rastet e sipërcituar llogaritet në shumën rreth **13,112,040 mijë lekë**. Kreditimi i Tvsh-së për këto vlera punimesh. bie në kundërshtim me, pikën 8/a, 8/b dhe 8/d të nenit 20 të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar. Kreditimi i padrejtë i tatimit mbi vlerën e shtuar për këto investime ndikon drejtpërdrejtë në uljen e detyrimeve të pagueshme në buxhetin e shtetit apo përfitimin e padrejtë të rimbursimeve për këtë tatim. Theksojmë se, vlera e mësipërme e llogaritur bazuar në Pasqyrat Financiare të depozituara nga shoqëritë pranë QKB-së ka tendencë rritje, pasi në të nuk përfshihet viti ushtrimor 2018, pasqyrat financiare të të cilit ende nuk janë publikuar. Megjithëse mungesa e lejeve në kryerjen e punimeve prej AKBN-së është evidentuar në raportet e monitorimit të dërguar periodikisht drejt Autoritet Kontraktor (MIE), nuk evidentohet një përcjellje informacioni lidhur me këto mangësi pranë administratës tatimore për vlerësimin dhe trajtimin fiskal të situatës duke bërë që bashkëveprimi midis institucioneve kundër evazionit fiskal dhe paligjshmërisë të mbetet në nivele minimale, pavarësisht marrëveshjes dypalëshe të nënshkruar midis tyre dhe angazhimeve ndërinstitucionale të marra. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 98-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** AKBN të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve informacion të strukturuar për të gjithë shoqëritë zhvilluese me NIPT-et përkatës, të cilat nuk disponojnë leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit apo kanë vijuar ndërtimin në tejkalim të lejes (pavarësisht fazës ku ndodhen ndërtim/prodhim) si dhe të kërkojë informacion lidhur me shumat e Tvsh-së të përfituar padrejtesisht prej tyre. Mbi bazën e përgjigjes së DPT<sup>së</sup> të informohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

*Brenda datës 31.08.2019*

**1.2 Rekomandimi:** Të intensifikohet bashkëpunimi i AKBN-së me organet fiskale për HEC-et në fazë ndërtimi, në kuadër të marrëveshjes së lidhur, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve apo kryerjes së kontrolleve të përbashkëta.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 14 dosjeve të cilët kanë përfunduar punimet, janë lidhur me rrjetin energjetik dhe janë futur në fazën e prodhimit u konstatua se:

Në gjashtë Raporte të monitorimit të shqyrtuara për HEC-et, mungon propozimi me vlerën përkatëse sipas detyrimit kontraktual të penalitetit që rrjedh nga neni 23 “Sanksionet” i kontratës së koncesionit lidhur midis palëve që lidhet me vonesat në fillimin / përfundimin e punimeve.

Mungon llogaritja e penalitetit për mosrealizimin e prodhimit sipas detyrimit kontraktual për periudhën para daljes së VKM-së Nr. 332 datë 06.06.2018. Përgjithësisht dosjet e HEC-eve, nuk janë inventarizuar e arkivuar dhe dokumentacioni që përmbajnë është kryesisht fotokopje, çka ul shkallën e besueshmërisë së përfundimeve dalë nga të dhënat e dosjeve. Sa më sipër në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”. Vlera e penaliteteve të propozuara nga ana e AKBN drejt MIE, për moszbatim të kushteve të kontratës, për të cilat nuk disponohen aktet administrative për arkëtimin e tyre, vetëm për rastet e shqyrtuara shkon në rreth **2,025,281 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** MIE, sipas propozimeve të rekomanduara nga AKBN të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës së sanksioneve të cilat rezultojnë të pazbatuara prej rreth **2,025,281 mijë lekë**, si dhe të informoj Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontabilizimin e tyre.

*Menjëherë*

## **C.2 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:-** Nga auditimi u konstatua se, AKBN disponon sistemin elektronik Re..... sipas kontratës së furnizimit nr. 1652/1 prot. Datë 30.12.2014. Ky sistem është implementuar dhe i shërben fushës Hidroenergjetike, Hidrokarbure, Minerare, dhe protokollit të brendshëm. Prej tij, administrata e AKBN por edhe Ministria e linjës mund të përpunojë raporte të ndryshme lidhur me ecurinë e projekteve për oponencë, investimeve por dhe shfrytëzimit të veprave sa i përket prodhimit. Në AKBN ky sistem aktualisht përdoret vetëm në fushën minerare, pra vetëm një nga disa fushat e punës të mundësuar, megjithëse në blerjen e tij janë shpenzuar rreth **18,358,320 lekë**, të cilat nuk kanë sjellë efektivitetin e pritshëm, si pasojë e keq menaxhimit nga strukturat drejtuese. Efektet negative vihen re qartë në, numrin e ulët të raportimeve nga ana e shoqërive për informacionet periodike apo progresive, mungesa e të cilave ka ndikuar në kryerjen në kohë dhe me cilësi të monitorimeve nga strukturat përgjegjëse, për investimet e kryera në hidrocentrale si dhe monitorimin në vijueshmëri të prodhimit të energjisë elektrike të tyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 17-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** AKBN, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative për vënien në funksion të sistemit *Re.....*, për protokollin e brendshëm dhe veprimtarinë hidroenergjetike për të garantuar përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.

*Brenda datës 30.09.2019*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e pagesave të kryera për periudhën nën auditim konstatohet se, AKBN ka kryer shpërblimin e anëtarëve të brendshëm të grupit OT-së në periudha mujore sipas urdhrin të Ministrit nr.39, datë 18.02.2015, veprim i cili bie ndesh me përcaktimet Rregullores nr. 6453/8 prot. datë 18.10.2010, e ndryshuar, “Për funksionimin e grupit për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN” konkretisht nenit 3, pika 5 ku përcaktohet se; “*Numri i specialistëve të jashtëm dhe shpërblimi i tyre*

*përcaktohen me vendim të këshillit drejtues të AKBN*". Kjo dispozitë përcakton vetëm kompetencat e Këshillit Drejtues lidhur me numrin e specialistëve të jashtëm, por në të nuk trajtohet pagesa dhe shpërblimi i punonjësve të brendshëm. Megjithatë kjo problematikë është trajtuar edhe gjatë auditimit të mëparshëm AKBN vijon të kryej pagesat për anëtarët e OT, punonjës të brendshëm të institucionit. Pavarësisht përcaktimit të pikës 5 më sipër, organet kolegjiale drejtuese të njërive publike nuk kanë kompetencë ligjore për përcaktimin e masës së shpërblimit kompetencë e cila sipas ligjit nr.10405, neni 4 pika 3 i përket Këshillit të Ministrave. Vlera e pagesave të kryera në mungesë të akteve ligjore mbështetës, llogaritet në **4,060,000 lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 70-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të shfuqizojë urdhrin për shpërblimin e anëtarëve të brendshëm pjesë e Oponencës Teknike i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë kompetencën e dhënies dhe masës së shpërblimit.

*Menjëherë*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *i rekomandohet* Drejtorit Ekzekutiv që: "Në bazë të analizës së përgjegjësive, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore përkatëse".

#### **E. NJOFTIMI I MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Nisur nga problematikat e konstatuara nga në auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për veprimtarinë nga data 01.09.2016 deri më datën 31.12.2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit të dërgojë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të marrë në konsideratë dhe vlerësuar mangësitë dhe shkeljet e nëpunësve publikë nën kompetencën e kësaj Ministrie, si dhe marrjen e masave përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

#### **F. NJOFTIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE**

Nisur nga problematikat e konstatuara në auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për veprimtarinë nga data 01.09.2016 deri më datën 31.12.2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit të dërgojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, një informacion përmbledhës lidhur me problematikat e konstatuara në kreditimin TVSH<sup>së</sup> apo përfitimin e padrejtë të rimbursimit në vlera të konsiderueshme financiare nga ana e shoqërive zhvilluese të veprave Hidroenergjetike (HEC), si dhe të kërkoj konfirmimin e vlerës financiare në shkelje të disiplinës fiskale për gjetjen C.1.1/1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **G. NJOFTIMI I DREJTORISË SË INSPEKTIMIT FINANCIAR NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Nisur nga problematikat e konstatuara në auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për veprimtarinë nga data 01.09.2016 deri më datën 31.12.2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit të dërgojë pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar pranë MFE, një kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të marrë në konsideratë dhe vlerësuar ekzistencën e parregullsive në vlera të konsiderueshme financiare për buxhetin e shtetit, si dhe shkeljet e detyrës në gjithë zinxhirin administrativ nga ana e nëpunësve publikë përgjegjës për fushën hidroenergjetike.

## **GJ. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do vlerësojë marrjen e masave, nga AKBN dhe MIE për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të monitorimit, mbikëqyrjes dhe shfrytëzimit sa më mirë të burimeve natyrore, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim dhe në dobi të popullit shqiptar.

## **H. VLERËSIMI NGA DEPARTAMENTI JURIDIK I KLSH-së**

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi nr.32 datë 30/07/2019 i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përcillen pranë Departamentit Juridik të KLSH-së, për të vlerësuar dhe gjykuar nëse në përmbajtjen e tyre ekziston ose jo ndonjë element i figurës penale apo indicjes penale.

## **I. TË TJERA**

*Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë këtij auditimi dhe rëndësia ekonomike që veprat hidroenergjetike kanë, lidhja dhe zbatimi i kontratave për këto vepra do të përfshihet në auditimet që do të zhvillohen nga KLSH në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ose në një auditim tematik brenda vitit 2019 ose tremujorit të parë të vitit 2020.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**